



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 27.09.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR .8331, DATË 21.4.1998 “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE”, I NDRYSHUAR

Drejtuar: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në mbledhjet e datës 25.09.2018 dhe 04.10.2018, në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr .8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator deputeti Xhemal Qefalia.

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është përmirësimi i procedurës së vënies në ekzekutim të vendimeve penale dhe urdhrave të tjera ligjore nga organet e caktuara me ligj për zbatimin e tyre. Ndryshimet e disa dispozitave synojnë përmirësimin e ekzekutimit vullnetar, rritjen e rolit mbikëqyrës të Shërbimit të Provës në ekzekutimin e vendimeve penale, në mënyrë të veçantë për vendimet me qëndrim në shtëpi, rregullimi i procedurës të rasteve kur i dënuari ndryshon vendbanimin e tij si dhe përcaktimin e kohës së fillimit të vuajtjes së dënimit.

II. OBJEKTIVAT E PROJEKTLIGJIT

Objektivat e këtij projektligji janë :

- Përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues në lidhje me ekzekutimin e masave edukuese dhe mjekësore dhe krijimin e institucioneve të posaçme për ekzekutimin e këtyre masave.

- Garantimi i ekzekutimit të drejtë dhe të njëjtë të vendimeve gjyqësore në respektim të parimit të lirisë dhe sigurisë së personit.
- Ridimensionimi i rolit të gjykatës dhe të prokurorit në ekzekutimin e dënimeve penale, duke synuar rritjen e efektshmërisë së sistemit të ekzekutimit.
- Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të burgjeve bazuar në harmonizimin e vazhdueshëm me standardet ndërkombëtare dhe krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e tyre.
- Krijimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë, të pajisur me burimet e nevojshme materiale dhe njerëzore për trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të stafit të administratës së institucioneve penitenciare dhe të Shërbimit të Provës.

III. ÇËSHTJET KRYESORE QË TRAJTON PROJEKTLIGJI

Projektligji përbëhet nga 8 nene.

Neni 1 i projektligjit ndryshon nenin 24 në të cilin shtohet një paragraf për të saktësuar procedurën e verifikimit të adresës të vendbanimit të të dënuarit nga organet e policisë së rendit të cilat ngarkohen me zbatimin e urdhrit të ekzekutimit.

Neni 2 i projektligjit, ndryshon nenin 31/4 paragrafi 2 i cili synon të rregullojë mënyrën e mbikeqyrjes nga Shërbimi i Provës të personave ndaj të cileve është marrë masa sigurimi “arrest në shtëpi” apo është dhënë një dënim alternativ.

Neni 3 i projektligjit ndryshon neni 31/6 paragrafi 6 duke rregulluar procedurën që duhet të ndjekin zyrtarët e shërbimit të parës në rastet kur i dënuari nuk ka vendbanim në territorin që mbulon zyrën vendore apo e ndryshon atë.

Neni 4 i projektligjit shton një dispozitë të re me synimin që të rregullojë problemet e konstatuara në praktikat gjatë ekzekutimit në lidhje me përcaktimin e momentit të fillimit të vuajtjes së dënimeve alternative.

Neni 6 i projektligjit ndryshon nenin 39/2 me synimin që të përmirësojë procedurën e rasteve të nxjerrjes jashtë territorit të personave të debuar jo shtetas shqiptar.

Neni 7 ndryshon paragrafin 2 të nenit 46 me synimin për të përcaktuar procedurën që do të kryejë Policia e Shtetit në rastin e ekzekutimit të vendimeve me masë edukuese.

IV. DISKUTIME NË KOMISIONIN PËR SIGURINË KOMBËTARE

Për prezantimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr .8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, ishte ftuar deputetja firmëtare Znj. Vasilika Hysi si dhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Gjatë fjalës së saj, znj. Hysi theksoi se projektligji, i cili propozon disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, është paketë me ligjin “Për shërbimin e provës” dhe projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar”, i cili ende nuk është shqyrtuar në komisionet përkatëse parlamentare, pasi kanë ndikim dhe janë të lidhur organikisht me njëri-tjetrin.

Disa nga problematikat e konstatuara në praktikë, të vëna në dukje edhe në Dokumentin Analitik të sistemit të drejtësisë, janë:

- njoftimi i të dënuarve të cilët janë hetuar dhe gjykuar në gjendje të lirë dhe duhet të bëhet njoftimi për ekzekutimin vullnetar nga ana e tyre. Praktika ka evidentuar një sërë problemesh për paraqitjen e tyre për të filluar vuajtjen e dënimit .
- personat për të cilët është vendosur masa e sigurisë “arrest në shtëpi”. Praktika ka treguar vështirësinë e hasur në mbikëqyrjen e personave, për të cilët gjykata ka dhënë “arrest në shtëpi” dhe për mënyrën e kontrollimit të sjelljes së tyre, me qëllim që në fund gjykata të aplikojë një politikë penale sa më të drejtë.
- rolin që luan Shërbimi i Provës në mbikëqyrjen e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, ë nuk ka qenë aspak i qartë, duke pasur parasysh edhe një vështirësi, që Shërbimi i Provës është një shërbim i ri, i krijuar në vitin 2009 dhe deri më sot rregullohet me vendimin nr.323 të Këshillit të Ministrave dhe projektligji ende nuk është miratuar në Kuvendin e Shqipërisë.
- koha e fillimi të vuajtjes së dënimeve alternative, shpesh ka qenë një debat dhe një problematikë e ngritur edhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, kur kanë raportuar Prokurori i Përgjithshëm, pasi është mundësia më e madhe për një aferë korruptive, që personi të mos paraqitet në kohën e duhur, por të paraqitet një javë para se të përfundojë periudha e dënimit. Pra, që nga momenti kur është dhënë dënimi i formës së prerë dhe deri në momentin kur personi paraqitet, mund të jetë një periudhë relativisht e gjatë dhe realisht i dënuari nuk vuan aspak ose nuk ekzekuton asnjë nga detyrimet që lidhen me vuajtjen e dënimeve alternative.

Në vijim të diskutimeve, nisur nga sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, vlerësoi ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore, dhe propozoi disa riformulime të dispozitave të këtij projektligji të cilat janë në koherencë me ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

V. RIFORMULIME NEN PËR NEN

- *Neni 1 projektligjit i cili ndryshon nenin 24 të ligjit aktual riformulohet si më poshtë :*

Neni 1

Pas paragrafit 1 shtohen paragrafët 2 dhe 3 me këtë përmbajtje:

Për të dënuarin me burgim ose me një nga alternativat e dënimit me burgim, i cili ka qenë në gjendje të lirë, ose ndaj te cilit është zbatuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi” ose “detyrim paraqitje”, organet e policisë së rendit të cilat ngarkohen me zbatimin e urdhrit të ekzekutimit, e kryejnë njoftimin duke shkuar në adresën e vendbanimit të të dënuarit dhe duke mbajtur procesverbal njoftimi me të dënuarin apo familjarët e tij, dhe kur kjo nuk është e mundur, njoftimi bëhet nëpërmjet specialistit të policisë se zones ku i dënuari ka vendbanimin.

Ne rastet e mbikqyrjes elektronike te personave, zbatimi i mbikqyrjes elektronike behet nga Sherbimi i Proves ne bashkepunim me organet e policise se rendit.

- *Neni 2 projektligjit i cili ndryshon nenin 34/1, paragrafi dytë, të ligjit aktual riformulohet si më poshtë:*

Neni 2

Shërbimi i provës mbikqyr ekzekutimin e vendimit te denimit me qëndrim në shtëpi, në mënyrë të vazhdueshme, deri në vuajtjen e plote te denimit dhe bashkëpunon sipas rastit, me autoritetet e pushtetit vendor, shërbimet sociale, organet vendore të policisë si dhe subjekte të tjera, private dhe shtetërore.

Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3,4,5,6,7 me këtë përmbajtje:

Kur personi i dënuar me vendim me qëndrim në shtëpi synon të ndryshojë vendbanimin, duhet t'i drejtohet Gjykatës duke dhënë motivet përkatëse.

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të ndryshojnë vendbanimin, për plotësimin e nevojave te domosdoshme familjare, per t'u angazhuar ne veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose per programe rehabilitimi për të cilat Shërbimi i Provës është dakort.

Ne kete rast gjykata percakton masat qe duhet te marre Sherbimi i Proves.

Shërbimi i Provës në rastet kur gjykata vendos ndryshimin e vendbanimit, zbaton masat e percaktuara ne vendim nga gjykata dhe ia përcjell praktikën e ekzekutimit për të dënuarin, zyrës perkatese vendore ku i denuari ka vendbanimin e ri.

Shërbimi i Provës njofton në lidhje me ndryshimin e vendbanimit organet vendore të Policisë së Shtetit si dhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit.

- *Neni 3 projektligjit i cili ndryshon nenin 34/6, paragrafi 6, të ligjit aktual riformulohet si më poshtë:*

Neni 3

Kur personi i liruar me kusht, kerkon të ndryshojë vendbanimin, ai duhet të njoftojë paraprakisht Shërbimin e Provës.

Pas paragrafit 6 shtohet paragrafi 7,8,9,10 më këtë përmbajtje :

Zyra vendore e cila ka mbikëqyrur deri në atë moment të dënuarin, ia përcjell praktikën e ekzekutimit për të dënuarin, zyrës perkatese vendore ku i dënuari ka vendbanimin e ri.

Kur personi i liruar me kusht kerkon të ndryshojë vendbanimin, ai duhet të njoftojë paraprakisht Shërbimin e Provës.

Zyra vendore e cila ka mbikëqyrur deri në atë moment të dënuarin, ia përcjell praktikën e ekzekutimit për të dënuarin, zyrës perkatese vendore ku i dënuari ka vendbanimin e ri.

Shërbimi i Provës njofton në lidhje me ndryshimin e vendbanimit organet vendore të Policisë së Shtetit si dhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit.

- *Neni 4 projektligjit i cili pas nenit 31/9 shton nenin 31/9/a, riformulohet si më poshtë:*

Neni 4

Kur për arsye të përligjura, i dënuari e fillon vuajtjen e dënimit alternativ më vonë sesa koha kur vendimi ka marrë formë të prerë, shërbimi i provës i kërkon prokurorit, të përcaktojë si datë të fillimit të afatit të mbikëqyrjes, datën kur i dënuari ka vendosur kontaktin e parë me Shërbimin e Provës.

- *Neni 6 i projektligjit i cili ndryshon nenin 39 paragrafi 2 të ligjit aktual, riformulohet si më poshtë:*

Neni 6

Kur i dënuari ka pasur dënim kryesor burgimin, nxjerrja e tij jashtë territorit ekzekutohet nga policia e burgjeve dhe Drejtoria e Migracionit ne Policine e Shtetit, të cilat menjëherë pas përfundimit te vuajtjes së dënimit kryesor, marrin masat përkatëse për nxjerrjen e të dënuarit jashtë territorit.

Pas paragrafit 2, shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje :

Kur kjo nuk është e mundur të realizohet menjëherë, i dënuari dërgjohet në një vend të përshtatshëm, deri sa të plotësohen kushtet për largimin e tij nga territori.

➤ Neni 7 i projektligjit i cili ndryshon nenin 46 paragrafi 2 të ligjit aktual, riformulohet si më poshtë:

Neni 7

Kur nuk bëhet ekzekutim vullnetar në datën e caktuar ose kur i mituri nuk ka prindër apo kujdestar, ekzekutimi i masave edukuese bëhet nga punonjësi i Policisë së Shtetit i specializuar dhe i trajnuar në drejtësinë penale për të mitur.

Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje:

Punonjësi i Policisë së Shtetit merr masat përkatëse për ekzekutimin e vendimit me të cilin është marrë një masë edukuese ndaj të miturit, duke e shoqëruar atë së bashku me një punonjës social ose psikolog të specializuar në drejtësinë penale për të mitur.

VI. PËRFUNDIME

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji që ridimensionon ligjin aktual, miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

RELATOR

KRYETARE

XHEMAL QEFALIA

ERMONELA VALIKAJ (FELAJ)

